



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS  
SINDIKAT POLICIJE KOSOVA  
KOSOVO POLICE UNION



Nr./Br.No. 01/001/24 Nr.faq/Br.str./No.pg. 3

Data/Datum/Date 30.01.2024

PRISHTINË-PRISHTINA-PRISHTINE



**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT**

**NË MES TË**

**SINDIKATËS SË POLICISË SË KOSOVËS**

**DHE**

**APR SH.P.K.**

**( ASISTENCË E PËRGJITHSHME RRUGORE)**

**PËR**

**OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ASISTENCËS RRUGORE**

**PRISHTINË, Janar 2024**

## Neni 1

### Qëllimi

1. Ky memorandum mirëkuptimi ( me tej : MM ) ka për qëllim :
2. Ofrimin e shërbimeve të asistencës rrugore në Kosovë dhe Evropë për punonjësit e PK-së

## Neni 2

### Palët nënshkruese

Palë nënshkruese të kësaj marrëveshje janë:

1. **z.Arianit Humolli** , përfaqësues nga APR SH.P.K ( Asistencë e Përgjithshme Rrugore ) me seli ne Rr Garibaldi, Prishtinë Hy 13,Kati 2 , Nr. 8 me numër biznesi 810025058
2. Sindikata e Policisë së Kosovës, me numër fiskal 600595899, Rr. Luan Haradinaj p.n. Prishtinë, Tel.383(0)385080/1300, E-mail:info@spk-rk.eu, përfaqësuar nga Kryetari z.Imer Zeqiri.

## Neni 3

Palët nënshkruese të këtij MM pajtohen që me vullnetin e tyre të plotë të bëjnë ndarjen e përgjegjësiive që do të jenë objekt i kësaj marrëveshjes mirëkuptimi sipas nenit 4.

## Neni 4

### Obligimet dhe përgjegjësitë e palëve

1. **Asistenca e Përgjithshme Rrugore - APR** me seli në Prishtinë do të ofroj shërbime me zbritje për shërbimet e asistencës rrugore si:
  - 1.1 Pako APR Evropë me zbritje prej 17% për automjetet me vit prodhimi 2005 e sipër
  - 1.2 Pako APR Plus me zbritje prej 25 % për automjetet me vit prodhimi 2000 e sipër
2. Të gjithë anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe një anëtar i familjes së ngushtë, përfitojnë këtë zbritje, me rastin e abonimit duhet të identifikohen me letërnjoftim dhe kartelën identifikuese të Policisë.
3. Secili punonjës i Policisë së Kosovës mund të abonoj një veturë për vete dhe një për anëtarin e familjes së ngushtë, me këtë ofertë ekskluzive, abonimi mund të bëhet edhe nëse vetura nuk është e regjistruar në emër të pjesëtarit të Policisë së Kosovës.

Neni 5

Zgjedhja e mosmarrëveshjeve

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje marrin për sipër që të gjitha mosmarrëveshjet t'i zgjedhin me negociata dhe mirëkuptim.

Pjesë e kësaj marrëveshje mirëkuptimi do të jetë forma e kushteve/ kriterëve për abonim

Neni 7

Hyrja në fuqi

Marrëveshja hynë në fuqi me datën e nënshkrimit nga palët nënshkruese dhe do të vlejë për 2 (dy) vitet pasuese nga data e nënshkrimit.

Kjo marrëveshje është e shtypur në gjuhën shqipe në dy ekzemplar original, për secilën palë nga një.

Në Prishtinë

Datë 30.01.2024

Palët nënshkruese:



z. Imer Zeqiri

Kryetar i Sindikatës së Policisë



Drejtor Menaxhues në APR

